

**DY PORTRERE LETRARE PËR PATER GJERGJ FISHTËN****TWO LITERARY PORTRAITS FOR PATER GJERGJ FISHTA****Loreta LOLI<sup>1</sup>***1\* Department of Literature, Faculty of History and Philology, University of Tirana**\*Corresponding author e-mail: loreta.loli@gmail.com***Abstract**

According to the researcher Jup Kastrati, the literary portrait in Albanian literature stood out with Faik Konica, who has left us excellent models. Initiator of many things in Albanian literature, Konica wrote in 1930s "Some memories about Át Gjeçov", an impressive portrait for the Franciscan friar, which he aesthetically synthesized with the words "a humble height". Another Franciscan friar, this time much better known, a living legend and a milestone for the Albanian literature, also crowned as the national poet - Pater Gjergj Fishta, will become the subject of literary portraits.

The realizations will come from Branko Merxhani and Vangjel Koça. We are interested on a detailed analysis of these writings made from two well-known Albanian publicists and literary critics of the 1930s, because, firstly, it results that they are little evident for the reader and, secondly, they come from two authors that are part of the cultural elite, who were lucky enough to meet the Poet, bringing us through literary memories impressions and details that enrich the great portrait of Gjergj Fishta.

**Keywords:** Literary portret, Gjergj Fishta, Branko Merxhani, Vangjel Koça, Albanian literature etc.

**Përmbledhje**

Sipas studiuesit Jup Kastrati, portreti letrar në letërsinë shqipe spikati me Faik Konicën, i cili na ka lënë modele të shkëlqyera në këtë zhanër. Nismëtar për shumëçka në letërsinë tonë, Konica solli në vitin 1930-të "Ca kujtime mbi Át Gjeçovin", një portret mbresëlënës për fratin françeskan, të cilin e sintetizoi estetikisht me fjalët "një lartësi e përulur". Një tjetër frat françeskan, këtë herë shumë më i njohur, një legjendë e gjallë dhe gur themeli për letërsinë shqipe, ndryshe i kurorëzuar edhe si poeti kombëtar - Patër Gjergj Fishta, do të bëhet objekt i portreteve letrare.

Realizimet do të vijnë nga Branko Merxhani dhe Vangjel Koça. Na shfaqin interes për t'u ndalur në analizë shkrimet e dy publicistëve dhe kritikëve letrarë të mirënjohur të botës shqiptare të viteve 1930-të, sepse, së pari, na rezulton të jenë pak të evidentuara për lexuesin dhe, së dyti, se vijnë nga pena që janë pjesë e elitës kulturore, të cilët patën fatin që të takohen me Poetin, duke na sjellë përmes kujtimeve letrare impresione dhe detaje që i shtohen portretit të madh të Gjergj Fishtës.

**Fjalët kyçe:** Portret letrar, Gjergj Fishta, Branko Merxhani, Vangjel Koça, letërsia shqipe etj.

Për lexuesin e specializuar, që e gjurmon tekstin letrar në kohë, fondi i periodikut retrospektiv shqiptar vazhdon të mbetet një burim i madh informacioni, sepse aty pasuria publicistike-letrare është e madhe dhe “e re”. E madhe, nga rëndësia që paraqet për tema, çështje, probleme studimore, autorë, dhe “e re”, sepse ka pjesë të paqëmtuara të cilat ndihmojnë për të shtuar e shkelur aspekte origjinale të letërsisë shqipe të vështruar si sistem. Siç dihet, shtëpitë botuese morën hov në vend pas viteve 1940-të; më parë autorët komunikonin me lexuesin thujse vetëm përmes gazetave dhe revistave, të shumta e të llojllojshme, që lulëzuan veçanërisht gjatë 1920-ës e 1930-ës.

Për figura të rëndësishme, si në fushën e letrave si në të gazetarisë konsultimi me burimet e periodikut retrospektiv gjithmonë do të sjellë interes, sepse fondi i tij, siç e përmendëm, është ende i madh. Duke u marrë tashmë prej afro një viti me sistemimin e kontributit që ka lënë në fushën e kulturës, të publicistikës, pedagogjisë, historisë, albanologjisë, kritikës letrare, letërsisë etj., Branko Merxhani, ku disa rezultate për shkrime shumë pak të njohura për lexuesin kemi patur mundësinë t’i ndajmë në konferenca të mëparshme brenda e jashtë vendit, puna e sollti që këtë herë faqet e gazetës “Demokratia” të na ndeshin me dy pjesë të tjera interesante. Interesante, sepse mbajnë ekzaktësisht të njëjtin titull edhe pse janë shkruar nga dy autorë të ndryshëm, dhe se shkak të drejtpërdrejt të krijimit kanë të njëjtën ngjarje biografike që lidhet me objektin e përbashkët të interesit.

Shkrimet titullohen thjesht “Pater Gjergj Fishta”. Njëri i takon Branko Merxhanit dhe tjetri Vangjel Koçës. I pari, V. Koça, në 7 nëntor të 1931, dhe një muaj më pas Merxhani, 19 dhjetor 1931, do t’i kushtojnë Gjergj Fishtës, me rastin e përvjetorit të 60-të të ditëlindjes, një shkrim përkujtues në gazetën gjirokastrite “Demokratia”. Vangjel Koça, duke marrë shkas nga botimi i numrit të veçantë të “Hyllit të dritës” (tetor 1931), me rastin e festimit të përvjetorit të lindjes të atit shpirtëror të kësaj reviste, Gjergj Fishtës, në vazhden e saj, pohon, se u bashkua në këtë festë kombëtare edhe gazeta “Demokratia” dhe shtypi shqiptar, për ta nderuar *“Këngëtarin homerik të Besës dhe të Trimërisë Shqiptare.”*<sup>236</sup>

Por, edhe pse e vlerëson fort veprimin si një akt kulturor dhe qytetar, megjithatë, thotë, kaq nuk mjafton. Kremtimi i ditëlindjes së Fishtës nuk duhej të kufizohej vetëm në kolonat e “Hyllit të dritës” dhe të gazetave shqiptare. Përkujtimi i tij do të duhej të shtrihej në tërë sistemin arsimor, ku të *“kujtohej me gjuhën e thjeshtë të djalit jeta dhe puna e Njeriut që ia ka falur vetëhen Atdheut dhe Këngës.”*<sup>237</sup> Rasti i Fishtës i shërben autorit për të ndërfutur në tekst figura të tjera kombëtare, si për shembull Andon Zako Çajupin, i cili, po njësoj, kur ndërroi jetë në Egjipt katër muaj më parë, duhej të ishte kujtuar me nder dhe respekt për çfarë bëri për kombin dhe jo të lihej i harruar, i shoqëruar vetëm nga lajmi i shkurtër i vdekjes, për të cilin, siç shprehet Koça, gjithsesi *“gazetës ‘Ora’ duhet t’ia dimë për të mirë që botoi edhe lajmin e vdekjes së tij në një qoshe të voçkëlë e të futurë të saj...”*<sup>238</sup>

Shkrimi i V. Koçës nuk është i gjatë, megjithatë dhe në kaq hapësirë ligjërimore që mban shtron për bisedim mendor ide të rëndësishme që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar e mirëzhvillimin e shoqërisë, tema që prekin reagimin e lexuesit, që ky të ndërgjegjësohet mbi trajtimin e merituar të vlerave kombëtare. Këto tema doemos e kushtëzojnë autorin të zgjerohet drejt arsytimeve duke u larguar nga lidhja e ngushtë që do duhej të mbante me objektin i tij të parë të interesit shkrimor, d.m.th. me Gjergj Fishtën. Për pasojë, gjuha e përdorur mbetet në pjesën më të madhe informuese dhe vlerësuese, kurse prania autoriale është distante nga objekti i vëzhgimit, veçanërisht nga vizualiteti mbi të. Imazhi pamor është nga elementët kryesorë të zhanrit të portretit letrar, që lidhet me strukturën e tij dhe në rastin e mësipërm ai mungon. Nuk ndodh kështu me Branko Merxhanin.

<sup>236</sup> “Demokratia”, 7 nëntor 1931, fq.3

<sup>237</sup> Po aty.

<sup>238</sup> Po aty.

Përmes kujtimeve të freskëta dhe të pasura, dhe subjektivitetit të spikatur autorial ai arrin të realizojë nga fillimi në fund një portret dinamik, me ngjyra, të Poetit. Proza e Merxhanit qartësisht i takon zhanrit të portretit letrar dhe përcjell interes të veçantë për analizë si për subjektin shkrues ashtu dhe për objektin e trajtuar përmes gjuhës letrare, sepse me kujtimet e ndara sjell detaje interesante që e pasurojnë jetën e të dyve. Sipas studiuesit Jup Kastrati, në letërsinë shqipe portreti letrar spikati me Faik Konicën, i cili na ka lënë modele të shkëlqyera në këtë lloj shkrimi. Nuk është i paqëllimtë klasifikimi tipologjik që u bën këtyre copëzave letrare në monografinë shumëvëllimore për Konicën, ku kapitullin përkatës e emërton “Portretisti”<sup>239</sup>.

Nismëtar për shumëçka në letërsinë tonë, Konica na solli në vitin 1930-të tekstin përkujtues “Ca kujtime mbi At Gjeçovin”, një portret mbresëlënës të fratit françeskan të vrarë një vit më parë, të cilin e sintetizoi estetikisht me fjalët “një lartësi e përlurur”. Në 19 dhjetor 1931, me titullin nominativ “Pater Gjergj Fishta”, nën rubrikën “Shënime nga Stambolli”<sup>240</sup>, Branko Merxhani sjell në një gjysmë faqe gazete portretin letrar për At Gjergj Fishtën. Për shumëkënd, nga intelektualët e rinj e të vjetër, figura e Fishtës që kthyer në një legjendë të gjallë, ndërsa vetë atë e quajtnë Poetin e Kombit, bashkë me Naim Frashërin e më pas edhe Jeronim De Radën.

Për Branko Merxhanin, që në ato vite ishte shndërruar në njërin prej figurave kryesore të jetës intelektuale shqiptare, kjo ishte hera e parë që e shihte nga afër dhe e takonte Poetin e Madh. Data e takimit të tyre përkon me një rastësi fort të bukur biografike, e cila la mbresa të forta te Merxhani duke u bërë shkak për krijimin e këtij portreti frymëzues fishtian: - u takuan në 23 tetor 1931 në Stamboll, ditën e lindjes së Poetit, në 60-vjetorin e tij! Në nisje teksti është i karakterit informativ, duke përcjellë njoftimin se ato ditë tetori të vitit 1931 në Stamboll kishte mbërritur me delegacionin shqiptar edhe Gjergj Fishta, që së bashku me personalitete të tjera përfaqësonte Shqipërinë në Konferencën e Dytë Ballkanike që mbahej në Turqi.

Por pikërisht, kur Merxhanit i duhet që t’i drejtohet Gj. Fishtës, e shmang gjuhën nominative dhe përdor metoniminë e hiperbolizuar, duke na përcjellë qartazi vlerësimin që ruan për të. E quan: Poeti ynë i math! “Si antar i Delegacionit t’onë për në Konferencën e Dytë Ballkanike erdhi në Stamboll edhe Poeti ynë i math! E shihja për herë të parë...”<sup>241</sup> Bie në sy përkujdesja e autorit në përzgjedhjen e fjalëve për të ndërtuar përmasën njerëzore të Fishtës. Përmes metaforave dhe epiteteve metaforike ai na sjell një Fishtë të butë e shumë njerëzor, njeri të paqtë, të mençur, ndijues të veçantë, artist elegant, tipare që deri diku e largojnë imazhin e tij nga epiku zëfortë i Lahutës së Malcís, të cilin, nga ana tjetër, Merxhani nuk harron ta përkujtojë përmes përshkrimit fizik: “Shtat i fortë, gjigantesk, i vajisur pak nga an’ e djathtë; qëndrim kryelartë, imponojës që të bie menjëherë në mëndje origjinën malësore të Poetit”<sup>242</sup>.

Autori kontribuon në krijimin e një figure të plotë të Fishtës, duke identifikuar pamjen e jashtme, veshjen, qëndrimin, gjestikulacionin dhe tiparet e karakterit. “Ashtu siç ishte i veshur me një par roba të zeza qytetari dhe me një jakë të bardhë të rumbullaktë në qafë, dukesh më tepër si një prift protestant. Flet shumë qetë, rëndë dhe duke menduar.”<sup>243</sup> Veçanërisht i bukur është përshkrimi i fytyrës së poetit, të cilin Merxhani ka zgjedhur ta bëjë përmes gjuhës poetike. Përtej tipareve të tjera, më fort vëmendjen e lexuesit e tërheqin sytë dhe flokët.

<sup>239</sup> Kastrati, Jup. *Faik Konica – Monografi*. “Gjonlekaj Publishing Company”, New York, Fq. 399.

<sup>240</sup> Këtë rubrikë Branko Merxhani e mbajti periodikisht në disa numra të gazetës “Demokratia”, si përfaqësuesi i saj në shtetin e ri modern turk për të ndjekur punimet e Konferencave Ballkanike që mbareshin aty. Nga ana tjetër, Branko Merxhani ishte përfaqësues i kësaj gazete për të përcjellë nga Turqia zhvillimet mbi konferencat ballkanike dhe për çështjen shqiptare.

<sup>241</sup> “Demokratia”, 19 dhjetor 1931, fq.3

<sup>242</sup> Po aty.

<sup>243</sup> Po aty.

Përdorimi i epitetit “të ëmbëlë” që i pranëvendoset emrit “hie” duke e kthyer në metaforë (hie e ëmbëlë), e cila është kështu (një hie e ëmbëlë) sepse të tillë e bëjnë “leshtrat e zeza të derdhura në anën e djathtë e të mëngjërë”, gjithë kjo gjuhë plastike, kaq delikate dhe adhuese, e denjë për një portret femëror, e bën imazhin e fratit françeskan shumë të veçantë, mbresëlënës, original: *“Që në fjalën e parë njeriu ndjen se gjëndet përpara një personaliteti të veçantë. Dy yje të çqetësuar e të lëvizëshme po ndritin nënë një ballë të gjerë, cilës i japin hie t’ëmbëlë një tufë leshrash të zeza të derdhura në anën e djathtë dhe të mëngjertë. Ca vija të paka, të holla, thua se të pa-dukura, janë të sklaisura këtu-këtje në fytyrën e tij të zeçkë dhe të qeverisur mirë.”*<sup>244</sup>

Gjatë ditëve të qëndrimit në Stamboll, midis Merxhanit dhe Fishtës bëhen tri takime, në tri ditë të ndryshme, në tri ambiente të ndryshme. Takimi i parë ndodh në “Pera Palace” – hoteli më i mirë i asaj kohe në Stamboll, i dyti, në Muzeun e Anitikiteteve në pallatin mbretëror “Topkapë”, ku, në dhomën e sarkofagëve statuja e “Efesit” e mahnit poetin, dhe takimi i tretë dhe i fundit në Bosfor, në udhëtimin me vapor që i shpie në ish pallatin e sulltanit në “Beylerbey”, ku shëtisin dhe pijnë çaj buzë detit. Dialogët dhe përshkrimet luajnë rol të veçantë, sepse, si pjesë strukturore e tekstit, përveçse bashkojnë elementet e dokumentit (personazhe historike, të dhëna nga konteksti kulturor-historik i asaj periudhe etj.) me letërsinë, po ashtu sjellin ritme të ndryshme në rrëfim, duke alternuar kohën e shkuar me të tashmen. Nuk ka sesi të mos na duket interesant takimi i parë mes dy personazheve, ku sjellja e Fishtës ndaj Merxhanit është e çiltër dhe origjinale: *“Duke kuvenduar me mua, m’u duk, për një çast, se mendimi i tij fluturonte gjatë. Më në fund ngriti me një herë qepallat e syvet dhe më tha me një zë shumë sympathik: -A! Ju j’ini, pra, zoti Merxhani? Sa doja që t’ju njihja. Veçanërisht Pater Anton Harapi shumë herë më ka bërë fjalë për juve dhe për ‘Demokratinë’. Do t’i shkruaj që ju takova. Sa do të kënaqet!”*<sup>245</sup>

Sikurse takimi i tyre i fundit, në përmbyllje të shëtitjes nëpër ujrat romantike të Bosforit, nuk të shkulet lehtë nga mendja, pasi e ke përfunduar të tërë pjesën. *“-Sa vjeç jini, Pater? - e pyeta (thotë Merxhani) Qëndroi në vend sikur i kisha kujtuar një gjë të pa-pëlqyerë. Dhe pasi bëri një levizje në erë me dorën e djathtë, m’u përgjigj me një zë shumë t’ëmbëlë: -Pikërisht sot hyj në të gjashtëdhjetat. ...Dhe shkeli me një herë në shkallën më të lartë. Ndjeva një të turbulluar në kokë sikur e kisha goditur te nonjë mur. Pëshpërta me vetëhe...Gjashtëdhjet vjet. Poet. Poet Kombëtar. ‘Lahuta e Malësisë’. Shkodrë, kryeqytet i Shqipërisë intelektuale. Gjer sot gjëra shumë të paka. Jetë mendore. Lëvizje. Aktivitet. Çaj rreth një havusi të mermertë. Pallate. Njerës të ditur. Shkretëtirë shpirtërore!... Hodha një sy në kalendarin t’im. Ishte 23 Tetor 1931.”*

Në thelb, portreti, në cilëndo formë arti që të dalë: qoftë pikturë, kinematografi, letërsi, jep tiparet kryesore të karakterit të personit, ato më të paharrueshmet. Portreti letrar, dhe këtu e kemi fjalën drejtpërdrejt për rrëfimin e gjatë, ku ai është fort i dallueshëm dhe organizues (zhanret e tregimit, të novelës dhe romanit), është mjet i rëndësishëm i karakterizimit të personazhit. Sipas drejtimeve të ndryshme letrare ka evoluar edhe portreti letrar si mjet i karakterizimit<sup>246</sup>.

Për shembull, roli parësor që kishte në letërsinë e shekullit XIX (të kujtojmë portretet e paharrueshme nga letërsia e Balzakut, Tolstoit, Gogolit etj.) ndryshon nga ai i letërsisë moderne e postmoderne, gjë që solli edhe ndryshime në teknikat rrëfimore që përdorën autorët. Pa u shtyrë më tej në trajtim, i cili do ta shpinte punimin në drejtim teorik me natyrë diakronike, mund të pohojmë se, pavarësisht “vështirësisë” që paraqet forma e zhanrit të shkrimeve që kemi në objekt studimi, ku përcaktimi i pastër zhanror i “portretit letrar” mungon nga kritikët<sup>247</sup>, si

<sup>244</sup> Po aty.

<sup>245</sup> Po aty.

<sup>246</sup> Heier, E. “The literary portrait’ as a device of characterization”. Në: “Neophilologus”, Vol. 60, 1976, fq.323.

<sup>247</sup> Mungon në fjalorë të ndryshëm ndërkombëtar të termave letrare zëri “portret letrar”.

pasojë e fluiditetit që ka gardhimi i termit (krijime mes letërsisë dhe publicistikës), ajo që mbetet e dukshme edhe te këto lloje shkrimesh është lidhja që ka ai me qëllimin e autorit në konceptimin e plotë të figurës së personazhit.

Përmes krijimit, portreti letrar është një element i rrëfimit, ndaj vlerësohet si rezultat i artit individual të autorit, një mënyrë e të shprehurit të “Uni-t” të tij<sup>248</sup>. Ajo që lexojmë nga pjesët e mësipërme, ku i pari (i Vangjel Koçës), edhe pse nga titulli sugjeron të shkojë drejt portretit letrar nuk del dot nga duart e esesë, dhe i dyti, i Merxhanit arrin të bëhet një portret i bukur letrar, është se të dy autorët, që janë njëherazi njerëz të dalluar në fushën e letrave dhe të punëve mendore nuk rendisin apo rregullojnë fakte për figurën e Fishtës, por ndajnë hapur vlerësimin, respektin e adhurimin e tyre për kontributin që Poeti dha për kombin dhe historinë e letërsisë shqipe.

Dhe në veçanti Merxhani, si pjesë të përvojës personale që e bashkëndan me lexuesin, e pasuron tablonë fishtiane, duke na sjellë copëza të bukura për Fishtë-Njeri, parë në një dimension ndryshe, origjinal, sa real aq edhe poetik. Prandaj, nëse Vangjel Koça realizon përmes esesë portretin formal të Poetit, Branko Merxhani, në anën tjetër, sjell portretin letrar intim të Poetit.

## Referencat

- [1]. Bazylova, B. K.; Suleimenova, Zh. D. (2012). “The Model of the Genre of Literary Portrait in Modern Literary Criticism”. Në: “International Journal of Humanities and Social Sciences” Vol:6, No:6, fq.1110-1113.
- [2]. Heier, E. (1976). “The literary portrait’ as a device of characterization”. Në: “Neophilologus”, Vol. 60, fq. 321-333.
- [3]. Koça, Vangjel. Në: “Demokratia”, nr. 307, 7 nëntor 1931.
- [4]. Merxhani, Branko. Në: “Demokratia”, nr. 311, 19 dhjetor 1931.
- [5]. Kastrati, Jup. *Faik Konica - Monografi*. “Gjonlekaj Publishing Company”, New York.
- [6]. “Hylli i dritës”, tetor 1931.

---

<sup>248</sup> Bazylova, B. K.; Suleimenova, Zh. D. “The Model of the Genre of Literary Portrait in Modern Literary Criticism”. Në: “International Journal of Humanities and Social Sciences” Vol:6, No:6, 2012, fq.1111-1112.